




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-32269/23 datë:15.12.2023



Npi – 01/462 datë: 27.12.2023

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), neni 17 shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Neni 12, 15, 16 dhe 17 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174; Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Planin Zhvillimor Komunal i miratuar më 31.10.2009 si dhe Planin Zhvillimor Urban i miratuar më 31.10.2009; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë: 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, si dhe procesit të mbajtur të diskutimit publik me qytetarë, në seancën e rregullt të mbajtur më datën 27.12.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

MIRATIMIN E STRATEGJISË TË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2024-2027

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IX- për vitin 2023, të mbajtur më: 27.12.2023, me shumicën e votave miratoi Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Shtimes për periudhën 2024-2027.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe diskutimin publik me qytetarë.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi